



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

## GJYKATA THEMELORE PEJË

---

AD/GJTHPE/.nr.11/23

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**, me Kryetarin e Gjykatës Armend Berisha, në procedurën disiplinore ndaj gjyqtares G. P., duke vepruar sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga A. M. nga P., me banim në Z., pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, jashtë seancës, me datë 22.11.2023, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** ankesa disiplinore e parashtruar nga A. M., ndaj gjyqtares G. P., **SI E PABAZUAR.**

### A r s y e t i m

Me datë 03.11.2023, parashtruesi i ankesës A. M. nga P., me banim në Z., ka parashtruar ankesë disiplinore ndaj gjyqtares G. P., me arsyetimin se në lëndën C.nr.111/20, gjyqtarja pa bazë ligjore ka marrë vendim për vendosjen e masës së sigurisë në pronën e këtij parashtruesit të ankesës disiplinore dhe se edhe përkundër faktit se ka vendos masën e sigurisë, e njëjta lejon mosrespektimin e kësaj mase nga ana e uzurpatorëve të cilët përveç shfrytëzimit të papenguar të pronës dhe objekteve afariste kanë ndërtuar edhe objekte shtesë. Po ashtu, i njëjti ka theksuar se nga gjykata angazhohet eksperti gjeodet që punon sipas direktivave dhe urdhrave të uzurpuesve të pronës së tij dhe bashkëpunëtorëve të tyre, i cili asnjëherë nuk i dorëzon ekspertizat brenda afateve ligjore, por i dorëzon në seancë. Gjithashtu, i njëjti ka theksuar se pavarësisht parashtrësës së dorëzuar nga ai me datë 20.06.2023, me të cilën e ka njoftuar gjykatën se nuk mund të marrë pjesë në seancën e datës 21.06.2023, pasi duhet të kthehet urgjentisht në Z. dhe e ka njoftuar gjykatën për revokimin e autorizimit ndaj avokatit të tij të mëparshëm, gjyqtarja në bashkëpunim me avokatin e mbajnë seancën gjyqësore, gjatë së cilës seancë avokatit të tij të paautorizuar i është kërkuar që pronat e palës të evidentohen vetëm me një numër kadastral, ashtu që përkohësisht do të heqet masa e sigurisë që të mund të realizohet synimi kriminal i uzurpuesve andaj, mbi bazën e të lartcekurave vlerëson se gjyqtarja nuk është neutrale dhe nuk pranon që ajo të ndajë këtë lloj drejtësie.

Me datë 03.11.2023, Kryetari i Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 par.5 të Ligjit mbi Përgjegjësitë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për ankesën disiplinore të parashtruar nga A. M. nga P., me banim në Z., ndaj gjyqtares G. P..

Gjyqtarja G. P., në deklaratën e saj të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e parashtruesit të ankesës ka deklaruar në përgjegjësi penale dhe materiale se asnjëra nga pretendimet e ngritura nga parashtruesi i ankesës nuk janë reale, por qëllimi i tij është vetëm pengimi i zhvillimit të procedurës dhe zgjidhjes së çështjes, duke sqaruar se me datë 03.10.2019, është ushtruar propozim për lëshimin e masës së sigurimit nga propozuesit Sh.M. dhe A. M. ndaj kundërshtarit të propozimit A. M. dhe gjykata me Aktvendimin C.nr.1202/19, ka caktuar masën e sigurimit, i cili vendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit, pas kësaj është ushtruar padia dhe janë mbajte disa seanca. Pala ankuese me palën paditëse janë vëllezër, kontesti është i natyrës tejet të rëndë, pala ankuese gjatë gjithë shqyrtimit kryesor ka qenë i përfaqësuar nga avokati A.N, ku i gjithë procesi është zhvilluar në prezencën e tij, pastaj i njëjti e ka autorizuar avokatin dhe asnjë seancë nuk është mbajte pasi që i njëjti e ka denoncuar autorizimin me datë 18.07.2023 andaj, konsideron se pakënaqësia e ankuesit është se lënda është afër marrjes së epilogut dhe lëndët sipas padisë së tij, të cilët janë në punë te gjyqtarët e tjerë nuk po gjykohen dhe kanë lidhshmëri mirëpo, nuk është kërkuar asnjëherë bashkimi i tyre dhe tani ju ka revokuar autorizimet dy avokatëve duke kërkuar që të komunikohet me të përmes e-mailit. Gjyqtarja ka sqaruar se në seancën e datës 19.09.2023, ka diskutuar me të paditurin, këtu parashtruesin e ankesës, lidhur me shqetësimet e tij sipas disa parashtrësive të dërguar përmes e-mailit, e që gjenden në shkresat e lëndës, të njëjtin e ka pyetur se a ka ndonjë vërejtje ndaj saj si gjyqtare dhe i padituri ka deklaruar se nuk ka vërejtje, por vërejtjet e tij janë më lëndët e tjera të tij e që kanë lidhshmëri me këtë lëndë dhe këto janë shënuar edhe në procesverbal në prezencë të tij. Ndërsa, lidhur me ekspertizën gjyqtarja ka sqaruar se plotësim i ekspertizës nuk ju është dorëzuar palëve me kohë, por ju është dorëzuar në seancë ku paditësit kërkuar që seanca të mbahet sepse ishte prezent edhe eksperti, ndërsa i padituri këtu parashtruesi i ankesës, e ka kundërshtuar një propozim të tillë dhe pa leje të gjykatës është larguar nga seanca e shqyrtimit kryesor, e cila seancë është shtyrë për datë 01.11.2023, i padituri është ftuar në mënyrë të rregullt dhe nuk ka prezantuar në seancë, e cila seancë serish është shtyrë për datë 27.12.2023, për shkak të dorëzimit të parashtrësive për precizim të kërkesëpadisë së paditësve, ku edhe është ftuar i paditurit dhe ju është dorëzuar kopja e parashtrësive për precizim të kërkesëpadisë. Andaj, konsideron se veprimet e të paditurit A. M., janë qartë te drejtuara në zvarritjen e procedurës dhe konsideroj se asnjë nga shkeljet e pretenduar nuk ekzistojnë.

Kryetari i Gjykatës duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj gjyqtarës G. P., së bashku me deklaratën e saj, ka gjetur se ankesa disiplinore është e pabazuar.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit të ankesës se gjyqtarja pa bazë ligjore ka caktuar masën e sigurisë në pronën e tij, autoriteti kompetent gjen se pretendimi i tij nuk hyn në domenin e shkeljeve të natyrës disiplinore të gjyqtarëve ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, por bëhet fjalë për çështje të vendimmarrjes së gjyqtarës, saktësia dhe ligjshmëria e së cilës është subjekt i vlerësimit nga gjykata e instancave më të larta në rast të ushtrimit të mjetit juridik nga pala e pakënaqur.

Autoriteti kompetent ka vlerësuar edhe pretendimet e parashtruesit të ankesës se gjykata angazhon ekspertin që punon sipas direktivave dhe udhëzimeve të palës tjetër dhe se gjyqtarja në bashkëpunim me avokatin e këtu parashtruesit të ankesës kanë mbajte seancën gjyqësore pasi të njëjtit ja ka revokuar autorizimin mirëpo, ka gjetur se pretendimet e tilla nuk janë të mbështetura në asnjë provë andaj, deklaratimet e mësipërme si të tilla dhe të paargumentuara nuk janë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve.

Nga arsyet e theksuara me lartë, konform dispozitive ligjore të nenit 9 par.6 të Ligjit mbi përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe nenin 7 par.3 pika 3.2 të Rregullores të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, AD/GJTHPE/.nr.11/23, me datë 22.11.2023**

**Kryetari i Gjykatës**

---

**Armend Berisha**

*Vendimi i dorëzohet:*

- 1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës*
- 2. Gjyqtares G. P.*
- 3. Parashtruesit të ankesës – A. M. (e-mail: ...@....)*